



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 28/2 Prot.

Tiranë, më 20/7/2011

**Lënda:** Rekomandim për “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi ,

**KONSTATOVA**

Më datë 02.06.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave.
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).

- Mjetet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale që përdoren konform kushteve dhe kriterëve të dispozitave të mësipërme.
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi, “**Konsullata e Përgjithshme Shqiptare**” Selanik, Greqi është kontrollues publik me seli në qytetin e Selanikut në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, kryen veprime të ndryshme konsullore pranë Ambasadës Shqiptare në Greqi mbështetur në ligjin nr. 8372 datë 09/07/1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore” si dhe të “Manualit konsullor” të MPJ-së datë 12/01/2010.

Ky kontrollues në ushtrim të detyrës dhe funksioneve të tij, nëpërmjet shërbimeve konsullore që ju ofron shtetasve shqiptarë (subjekte të të dhënave personale), që banojnë dhe jetojnë në Greqi, mbledh dhe përpunon të dhëna personale të tyre, të cilat mbarten në dokumente të ndryshëm që këta shtetas paraqesin pranë këtij kontrolluesi.

Gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ, grupi i kontrollit u njoh me procedurat që kryen kontrolluesi gjatë veprimeve konsullore, inspektoi praktikat dhe dokumentacionin që mban kontrolluesi për çdo veprim konsullor që iu afron shtetasve shqiptarë.

**Veprimet konsullore që kryen kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi gjatë të cilave ai mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale janë:**

1. Pajisja e shtetasve shqiptarë me letërnjoftime, pasaporta biometrike, lejë kalime, viza.
2. Veprime të gjendjes civile, lindjet, martesat, vdekjet etj..
3. Veprime noteriale, prokurat, legalizimi i dokumenteve.
4. Veprime të karakterit administrativ, lëshimi i vërtetimeve, përkthimet etj

**1) Pajisja e shtetasve shqiptarë me letërnjoftime, pasaporta biometrike, lejë kalime, viza.**

Pranë kontrolluesit, “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi, kryen procedurat e pajisjes së shtetasve shqiptarë me letërnjoftim dhe pasaporta biometrike si kundër në territorin e Republikës së Shqipërisë kompania “Aleat” ka ngritur zyrën e saj edhe në ambientet e kontrolluesit.

Kontrolluesi gjatë procedurës së aplikimit të shtetasve shqiptarë për letërnjoftim dhe pasaporta biometrike kryhen vetëm verifikimin e të dhënave personale të shtetasve nëpërmjet aksesit që ka në Regjistrin Kombëtar të gjendjes civile. Aksesin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në rrugë elektronike e ka vetëm një punonjës i kontrolluesit (konsulli i parë). Të gjitha procedurat e mëtejshme për pajisjen e shtetasve shqiptarë me letërnjoftim dhe pasaporta biometrike kryen nga kompania “Aleat”.

Kontrolluesi për rastet kur shtetasit shqiptarë kanë humbur pasaportën, rastet e mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës apo për fëmijët që kanë lindur në Greqi dhe nuk janë pajisur asnjë herë me pasaportë, bën pajisjen e këtyre shtetasve me lejkalimi me një afat përdorimi gjashtë muaj. Gjatë këtij procesi kontrolluesi ju mbledh këtyre shtetasve dokumentacion si; pasaporta me afat të përfunduar, fotokopje të pasaportës së humbur ose dokument të policisë, lejë për drejtim automjeti, vërtetim shkolle ose pune, certifikatë martesë, certifikatë lindje, certifikatë familjare, fotografi.

Të dhënat personale që mbartin këto dokumente janë emri, mbiemri, atësia, datëlindja, adresa, nr. i pasaportës, vendlindja etj.

Kontrolluesi për çdo shtetas (subjekt i të dhënave personale) që pajis me lejkalim krijon një praktikë e cila ruhet në dosje pranë arkivës së tij për një afat kohor një vjeçar. Kontrolluesi mban një regjistër të veçantë të shtetasve të pajisur me lejkalim ku regjistron emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, vendlindjen, autoritetin kërkues, data e lëshimit, afati i vlefshmërisë.

Kontrolluesi pajis shtetasit e huaj (subjekt i të dhënave personale) me vizë hyrje në Republikën e Shqipërisë bazuar në VKM 362 datë 01/04/2009 dhe VKM 431 datë 27/04/2009 e ndryshuar “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Shqipëri. Aplikimi bëhet online dhe i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ).

## **2) Veprime të gjendjes civile, lindjet, martesat, vdekjet etj..**

Kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi kryen funksione për veprime të gjendjes civile mbështetur në ligjin nr. 10129 datë 11/05/2009 “Për gjendjen civile”. Grupi i kontrollit u njoh me praktikën dhe dokumentet që mban kontrolluesi gjatë procedurave të regjistrimit të lindjeve, martesave, vdekjeve.

Gjatë këtyre procedurave kontrolluesi mbledh nga shtetasit (subjektet e të dhënave) dokumente të tilla si; certifikatë zyrtare të lëshuara nga autoriteti përkatës vendas të legalizuara, aktet e lindjes të përkthyer në gjuhën shqipe (për regjistrimin e lindjeve), certifikatë lindje, fotokopje të kartës së identitetit, certifikatë për lidhje martesë (për regjistrimin e martesave), certifikatë vdekje të lëshuara nga autoritetet vendase dhe të legalizuara, lejë për transportim, aktin e vdekjes dhe dokumente të tjerë shoqëruese nga autoriteti vendas (për regjistrimin e vdekjeve).

Në këtë dokumente mbarten të dhëna personale të shtetasve subjekte të të dhënave personale si emër, mbiemër, atësi, mëmësi, datëlindje, vendlindje, bashkëshorti/a, data e martesës, data e vdekjes, vendi i vdekjes, shkaku i vdekjes etj. Kontrolluesi për këtë lloj shërbimi krijon dosje me praktika të veçanta të cilat më pas i arkivon në ambientet e tij. Gjithashtu kontrolluesi ka hartuar regjistra të veçantë për shërbimet lidhur me regjistrimin e lindjeve, martesave, vdekjeve.

Në këto regjistra kontrolluesi regjistron shtetasit që ju ka afruar këtë shërbim duke pasqyruar disa të dhëna si; emër, mbiemër, atësi, mëmësi, datëlindje, vendlindje, bashkëshorti/a, data e martesës, data e vdekjes, vendi i vdekjes, shkaku i vdekjes etj

### **3) Veprime noteriale, prokurat, legalizimi i dokumenteve.**

Kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi kryen shërbime juridike noteriale bazuar në ligjin nr. 8372 datë 09/07/1998 “ Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore” dhe ligjin nr. 7829 datë 01/06/1994 “Për noterinë” të tilla si:

- Procesverbale për të dokumentuar fakte të ndryshme
- Deklarata, autorizime, testamente, kontrata, garanci dhe prokura të thjeshta
- Vërtetim nënshkrimesh
- Vërtetim kopje ose ekstrakte dokumentesh.

Pasi u këqyrën disa praktika të kontrolluesit lidhur me shërbime të ndryshme juridike u konstatua se, kontrolluesi gjatë kryerjes së këtyre shërbimeve mbledh prej shtetasve ( subjekte të të dhënave) të cilëve ju afron shërbim, dokumente të ndryshme të cilat mbartin të dhëna personale. Të dhënat personale që mblidhen nëpërmjet dokumenteve janë emri, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, numri i pasaportës , numri i kartës së identitetit, adresa, telefoni emali etj.

Kontrolluesi mban regjistra të veçantë për shërbimin që lidhet me prokurat, deklaratat, vërtetimet dhe legalizimet. Në këto regjistra ai regjistron të dhënat personale të shtetasve si: emër, mbiemër, objekti i prokurës, numri i prokurës, lloji i dokumentit, emri i titullarit të dokumentit, data e dokumentit, institucioni që ka lëshuar dokumentin, firma e legalizuar etj.

### **4) Veprime të karakterit administrativ, lëshimi i vërtetimeve, përkthimet.**

Kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi gjatë kryerjes së këtyre veprimeve me karakter administrativ mbështetet në ligjin nr. 8372 datë 09/07/1998 “ Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore” dhe vihet në kontakt me të dhënat personale të shtetasve që kërkojnë një shërbim të tillë, nëpërmjet identifikimi që ju bëhet pranë kontrolluesit apo dokumentacionit që ata paraqesin. Grupi i kontrollit konstatoi se, kategoria e veprimeve me karakter administrativ për kontrolluesin është një veprimtari e përditshme në ushtrim të funksionit të tij si shërbim konsullor. Për këto shërbime kontrolluesi nuk mban dosje me praktika të veçanta apo regjistra të veçantë, pranë zyrës së financës ai mban vetëm faturat financiare për shërbimin e kryer.

Gjithashtu u konstatua se, porsa i përket mjeteve dhe mënyrave të përpunimit të të dhënave personale kontrolluesi nuk bën përpunim automatik të të dhënave, nuk ka rrjet të brendshëm kompjuterik për përpunimin e të dhënave personale, të gjitha veprimet konsullore kryen në rrugë manuale nëpërmjet dokumenteve shpresore.

Nga kontrolli u konstatua se, kontrolluesi ka të instaluar një sistem videosurvejimi me kamera në hyrje, ambiente pritje, koridore, zyra, për të cilin gjatë intervistës u deklarua nga ana e

konsullit se sistemi është instaluar para disa kohësh në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, por aktualisht nuk është në funksion prej disa muajsh.

Grupi i kontrollit e konstatoi faktin e mosfunksionimit të sistemit të videovëzhgimit dhe përfaqësuesi i kontrolluesit (Konsulli i Përgjithshëm) në “procesverbalin e kontrollit administrativ” të mbajtur deklaroi se në rast të vënies në funksion të sistemit videovëzhgimit do të zbatohen kriteret e vendosura në udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”.

U konstatua se, kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik Greqi nuk ka plotësuar detyrimin për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas kërkesës së nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

**Ky kontrollues duhet të respektojë nenin 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” sipas së cilës ai detyrohet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.**

Lidhur me sigurinë e të dhënave personale u konstatua se, kontrolluesi zbaton “Manualin Konsullor”, “Skemën e ekspertizës dhe e klasifikimit në MPJ” të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme ku përshkruhen rregulla të përgjithshme mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së dokumentacionit. Në “Manualin Konsullor” konstatohet se, nuk ka rregulla të hollësishme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale konform neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

- Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik - Greqi , duhet të përmbushë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Konsullata e Përgjithshme Shqiptare” Selanik - Greqi të hartojë rregulla të hollësishme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale, që ju ngarkon ligji, të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA CABEJ (POGAÇE)**

